

ANILA ÇEPANI
ADELINA ÇERPJA

**PROBLEME TË PËRSHTATJES SË FJALËVE PËRCAKTUESE
ME EMRAT AMBIGJENË**

Në gjuhë të ndryshme indoevropiane, si në rumanisht, italisht, sllovakisht, çekisht, në greqishten e re etj., ekziston një klasë e caktuar emrash që në njëjës paraqiten si mashkullorë, kurse në shumës kalojnë në gjininë femërore. Këta njihen si emra ambigjenë. Kjo dukuri është e pranishme edhe në gjuhën shqipe. Në gramatikën e shqipes përmenden si emra ambigjenë ata që e formojnë shumësin më *-e* dhe disa më *-ra*. Këta janë kryesisht emra jofrymorësh të cilët shënojnë sende ose nocione abstrakte, me përjashtim të dy emrave që tregojnë veta (*personalitet / personalitete, personazh / personazhe*) dhe dy emrave që shënojnë qenie të vogla (*bakter / baktere, insekt / insekte*)¹.

Vendin më të madh në këtë grup të veçantë emrash të dygjinishëm, që qëndron midis gjinisë mashkullore dhe femërore, e zënë emrat që e formojnë shumësin më *-e* (*ballkon / ballkone, debat / debate, tekst / tekste, variant / variante, zjarr / zjarre* etj.), por ndërrimi i gjinisë vërehet edhe në shumësin e disa emrave ish-asnjanes, si dhe të emrave të lëndës me prapashtesën *-ra* (*bulmet / bulmetra, dhjamë / dhjamëra, miell / miellra, ujë / ujëra* etj.).

Shaban Demiraj në librin e tij *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*² përfshin në grupin e emrave ambigjenë dhe disa emra mashkullorë (ndonjë prej tyre me origjinë asnjanesë) që në shumës marrin *-a*: *hap / hapa, petk / petka*³.

¹ *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002, § 3.2.4, f. 92.

² “Në gjuhën shqipe e ndërrojnë gjininë në radhë të parë ata emra jofrymorësh që në shumës marrin mbaresën *-e*. Por siç do të vihet në dukje më poshtë kjo dukuri vihet re edhe tek emrat (në njëjës mashkullorë ose asnjanes, që në shumës marrin mbaresën *-ra* (geg. *-na*), e në disa raste edhe ata që marrin mbaresën *-a*.” Sh. Demiraj, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972, f. 52.

³ Po aty, f. 63.

Ndërsa Hysen Matoshi në artikullin *Çështje të ambigjinitë në gjuhën shqipe* sugjeron që në grupin e emrave ambigjenë të trajtohet si përjashtim dhe emri *interes*, ndonëse e formon shumësin me prapashtesën *-a: interesa jetësore, interesa kombëtare*⁴. Këtë përjashtim e përlij me faktin se shembujt nga fjalori shpjegues i shqipes dëshmojnë për ambigjentinë e këtij emri.

Ai sugjeron gjithashtu që emrat me prejardhje nga turqishtja të tipit *akraballëk, axhamillëk* etj. të trajtohen si një nëndarje e veçantë e emrave ambigjenë që shumësin e bëjnë me prapashtesën *-e (akraballëqe, axhamillëqe* etj.).⁵

Dukuria e ndërrimit të gjinisë së këtyre emrave në numrin shumë të është e vjetër⁶, ajo është e përgjithësuar në gjuhën letrare dhe është bërë e detyrueshme edhe nga norma. Gjuhëtarë të ndryshëm i kanë quajtur emrat e këtij tipi herë asnjës, e herë ambigjenë. Shaban Demiraj pranon si më të përshtatshëm termin ambigjen, sepse sipas tij ky term i jep më mirë tiparet gramatikore të këtij grupi emrash duke i dalluar ata nga emrat e tjerë mashkullorë që janë homogjenë në të dy numrat.

Duke u nisur nga fakti se ndërrimi i gjinisë së emrave në shumë është përhapur gjerësisht si në shqipe dhe në rumanishte, disa gjuhëtarë mendojnë se kjo ka një burim të përbashkët. Por sipas Demirajt, kjo dukuri në shqipe nuk ka lidhje me zhvillimin e saj në rumanishte, por është një zhvillim i brendshëm i pavarur i secilës gjuhë. Dy janë prirjet kryesore të lindjes dhe të përhapjes së kësaj dukurie:

zhdukja e kufirit të gjinive të emrat jofrymorë dhe veprimi i analogjisë.

Kjo dukuri ka qenë e përhapur në të folmet e dialektit verior, por tashmë është përhapur gjerësisht dhe është bërë normative.

Studiuesi Kolec Topalli në artikullin e tij *Rreth një paradigme të zhdukur të emrave të gjinisë femërore* hulumton evolucionin e një paradigme të zhdukur të emrave femërorë në periudha të ndryshme të zhvillimit të gjuhës. Ai arrin në përfundimin se duke u nisur nga përkatësia paradigmatiche e këtyre emrave në gjuhën e sotme, pjesa më e madhe e tyre

⁴ H. Matoshi, "Çështje të ambigjinitë në gjuhën shqipe", *Gjuha shqipe*, nr. 1-2, f. 56.

⁵ *Po aty*, f. 56.

⁶ Siç pohon Shaban Demiraj: "Dukuria e ndërrimit të gjinisë së emrave në shumë në gjuhën shqipe është relativisht e vjetër; ajo është përfutur që në periudhën paraletrare të shqipes, por koha e zanafillës së saj, për mungesë dokumentash më të vjetra, nuk mund të përcaktohet më tej...", në *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972, f. 65.

Probleme të përshtatjes së fjalëve përcaktuese me emrat ambigjenë


janë integruar në paradigmen e emrave mashkullorë me mbaresën zero: *pushtet-i, shëndet-i, turp-i, vullnet-i* etj.⁷ Këta emra sot përfshihen në grupin e emrave ambigjenë.

Për të parë se sa e përhapur është dukuria e ambigjenisë, në tabelën e mëposhtme jepen statistikave të nxjerra nga “Fjalori i gjuhës shqipe”, 2006:

Lloji i emrit	Nr. i emrave
Emra mashkullorë gjithsej	7894
Emra ambigjenë me shumësin më <i>-e</i> ⁸	2608
Emra ambigjenë me shumësin më <i>-(ë)ra</i>	15

Në bazë të statistikave të nxjerra nga fjalori, vërehet se emrat ambigjenë zënë një vend të konsiderueshëm në raport me emrat mashkullorë të gjuhës shqipe.

Emra mashkullorë gjithsej¹ Emra ambigjenë me shumësin më *-e*² Emra ambigjenë me shumësin më *-(ë)ra*³



Raporti i emrave ambigjenë me emrat mashkullorë

⁷ K. Topalli, “Rreth një paradigme të zhdukur të emrave të gjinisë femërore”, *Studime filologjike*, nr. 1-4, 1995, f. 21.

⁸ Këtu janë përfshirë dhe fjalët turke me prapashtesën *-llək* (31 të tilla) që në shumës dalin me qiellzorizim të bashkëtingëllores fundore dhe me prapashtesën *-e* njëkohësisht: *boshllək / boshllëqe, çapkënllek / çapkënlleqe, pisllek / pislleqe* etj.

Kjo dukuri gjen shprehje te mbiemrat dhe fjalët e tjera përcaktuese të gjinisë femërore që ata marrin në këtë numër, por shpeshherë përdoruesit e shqipes hasin vështirësi në përshtatjen e tyre me këtë kategori emrash.

Gjatë përdorimit të këtij grupi emrash vërehen shkallë të ndryshme vështirësish në përshtatje. Vihet re se për disa prej këtyre emrave mashkullorë, e konkretisht për emrat më *-im*, përshtatja e fjalëve përcaktuese bëhet natyrshëm edhe nga përdorues të zakonshëm të shqipes:

ai mendim i ri / ato mendime të reja
fillim i vështirë / fillime të vështira
ky veprim i arsyeshëm / këto veprime të arsyeshme

Por për disa emra të tjerë kjo përshtatje është më e vështirë jo vetëm për përdoruesin e zakonshëm, por dhe për ata që kanë një formim gjuhësor të niveleve të ndryshme:

diamante të tjerë / diamante të tjera
të gjithë afatet / të gjitha afatet
viruset e thjeshtë / viruset e thjeshta

Si fjalë përcaktuese të emrave shërbejnë mbiemrat, përemrat dhe numërorët. Shkalla e vështirësisë së përshtatjes së këtyre fjalëve përcaktuese me emrat ambigjenë nuk është e njëjtë.

Duke u nisur nga materiali i vjelë kryesisht nga shtypi i përditshëm, nga disa tekste shkollorë, nga literatura artistike, si dhe nga shkrime të ndryshme të afishuara në disa faqe në internet, le të shohim konkretisht shkallën e përshtatjes së secilës nga këto fjalë përcaktuese me këtë kategori emrash.

Fjalët përcaktuese mbiemra hasen më dendur se fjalët e tjera përcaktuese, por përdoruesit i përshtatin më lehtë me emrat ambigjenë në krahasim me përemrat dhe numërorët. P.sh. fjalia *Cilat janë romanet më të rëndësishme të krijimtarisë së tij?* do të dilte herë *Cilët janë romanet më të rëndësishme të krijimtarisë së tij?*, herë *Cilat janë romanet më të rëndësishëm të krijimtarisë së tij?* Megjithatë nuk janë të pakta përshtatjet e gabuara të mbiemrit me emrin. Brenda vetë klasës së mbiemrave vihen re shkallëzime të problemeve të përshtatjes:

Probleme të përshtatjes së fjalëve përcaktuese me emrat ambigjenë

Nga këqyrja e rasteve të përshtatjeve të gabuara të mbiemrave, del se më shpesh gabohet në përshtatjen e mbiemrave të nyjshëm në raport me mbiemrat e panyjshëm (92:29):

*Në muzeumet italiane, ndonjëherë sheh **ekrane të vegjël të ngjyrosur** që prifti mbante para fytyrës së të dënuarit që të mos shihte gjjotinën.*

*Ajo që kemi kuptuar është se nuk ka **buxhete të keq apo të mirë**, por qeveri që di ose nuk di të jetë e zonja të drejtojë shtëpinë tonë të përbashkët.*

*Pika të tjera do të ishin edhe **aeroporte të ndryshëm** si edhe stacionet e radarëve, që rezultojnë shumë dëmtuese për nëndetëset Gjermane.*

*Falënderimet për **albumet e rinj** shkojnë tek Saimiri në Angli dhe Shigjeta në Amerikë.*

*Këtë vit ishin në modë **stofrat shumëngjyrësh**.*

*Timo fillimisht e ka filluar me **role episodikë** duke luajtur “të huajin” në filmat amerikanë si rolin e arabit Mustafa në filmin “Evil Never Dies” i vitit 1999 për të arritur deri tek amerikanin “Johnson”.*

*Dy **albumet e saj të parë** ishin shumë popullore.*

Jo të gjithë mbiemrat e nyjshëm përshtaten njëllor. Përdoruesit hasin më shumë vështirësi në përshtatjen e mbiemrave të nyjshëm më *-shëm* dhe mbiemrave prejpjesorë më *-r* dhe *-ur*:

*Të rinjtë ngrenë sytë nga qielli, ku yjet gjuhen me gurë të ndezur dhe hëna kuq si gjaku zbret si një unazë me **diamante të flakërueshëm**.*

*“Ilaçet specifike që ndalojnë krizat e migrenës janë të shumta dhe kryesisht janë të familjes së triptanëve, që kanë **efekte të ngjashëm** në ndalimin e krizave.*

*Dita e zgjedhjeve u shënua nga një pjesëmarrje e lartë e votuesve dhe disa **incidente të dhunshëm të izoluar**.*

*Ajo zonë shquhet për **djathëra të shijshëm**.*

*Multitekstualiteti - variantet e së njëjtës vepër apo punë, d.m.th. **variantet e mëparshëm dhe të mëvonshëm** të së njëjtit tekst.*

*Por, kjo nuk do të thotë se ne qytetarët dhe **subjektet e bindur** duhet të jemi makina të ftohta që përmbarojmë një punë të caktuar.*

Përemrat janë një grup tjetër i fjalëve përcaktuese që për nga denduria e përdorimit qëndrojnë pas mbiemrave. Duke qenë një klasë

heterogjene, ata paraqesin shkallë të ndryshme vështirësie në përshtatjen me emrat ambigjenë.

Nga shembujt e vjelë nuk dalin raste tipike të përdorimeve të gabuara të përemrave pronorë me emra ambigjenë.

Nga përemrat e pacaktuar që kanë kategorinë gramatikore të gjinisë në numrin shumës janë *gjithë*, *tjetër* dhe *tërë* (*të gjithë/a*, *të tjerë/a*, *të tërë/a*). Janë pikërisht këta përemra që sjellin vështirësi në përdorimin me emra ambigjenë.

Përemri i pacaktuar *të gjithë* gabohet pothuaj me të gjithë emrat ambigjenë. Janë shumë të pakta rastet kur ai përdoret si duhet:

Por duke iu referuar Kodit Zgjedhor janë shkelur të gjithë afatet për të përgatitur një infrastrukturë zgjedhore që do të garantonte zgjedhje të lira e demokratike, të mira e të standardeve demokratike.

Të gjithë aksidentet në punë duhet të njoftohen, siç kërkohet nga ligjet dhe rregullat kombëtare, tek autoriteti kompetent, inspektorati i punës, institucioni përkatës i sigurimit, ose tek çdo organ tjetër brenda një periudhe kohe të përcaktuar.

Të gjithë mallrat që vijnë prej andej janë shumë cilësorë.

Sipas projektit, brenda 2 vitesh, të gjithë bizneset do të regjistrohen në një sportel të vetëm.

Vështirësi paraqet dhe përshtatja e përemrave të pacaktuar *tjetër* dhe *tërë*, por jo në të njëjtën shkallë si përemri *gjithë*.

Por, ato gjenetikisht janë të lidhura me bacile të tjerë dhe jo me mikrobaktere.

Butoni i menysë është një diamant prej 0.25 karatësh, ndërkohë që dhe diamante të tjerë zbukurojnë trupin e celularit.

Nëse ata pretendojnë se janë të talentuar dhe u hahet haku, le ta provojnë të luajnë në ekipe të tjerë.

Nëse vendi ynë me kapacitetin ujqor që ka, të kishte mundësi t'i shfrytëzonte, të tërë qytetet do të kishin hidrocentralet për të plotësuar nevojat e furnizimit me energji elektrike.

Shpesh ndodh që përdoruesit e shqipes kalojnë në hiperkorrektizma - rregullën e përshtatjes së fjalëve përcaktuese me emrat ambigjenë e përdorin edhe në rastet kur kjo rregull nuk gjen zbatim, p.sh.:

Probleme të përshtatjes së fjalëve përcaktuese me emrat ambigjenë

- a. *Këto mendime kundërshtojnë njëra-tjetrën.*
në vend të
- b. *Këto mendime kundërshtojnë njëri-tjetrin.*

Siç vihet re dhe nga shembulli, megjithëse në fjalinë (a) përdorimi i përemrit *njëra-tjetrën* vjen më se natyrshëm, trajta e saktë është forma e gjinisë mashkullore (b) e jo ajo femërore. Kjo ndodh sepse pavarësisht se fjala *mendime* është në numrin shumës, secili mendim kundërshton tjetrin, pra ruhet gjinia mashkullore e përemrit sepse ai i referohet fjalës *mendim* në numrin njëjës.

Këmbimi i formave të gjinisë femërore me atë mashkullore vihet re dhe në përdorimin e përemrit të pacaktuar *njëri* kur u referohet emrave ambigjenë:

Në dyqan kishte shumë albume, por unë zgjodha njërin me kapak të kaltër.

Gabime të shumta hasen në përdorimin e përemrit dëftor *këta* në vend të formës së duhur *këto* kur paraprin emrat ambigjenë:

Si pedagog i vetëm themelues, i është dashur që krahas zhvillimit të punës pedagogjike me studentët, të merret dhe me veprimtari pedagogjike krijuese për të siguruar repertorin teknik dhe artistik për këta instrumente.

Dhe shpesh kjo funksionon sepse edhe vuajtja e dashurisë, ashtu si depresioni, duket se ka të bëjë me një ulje të nivelit të serotoninës, për të cilën shërbejnë këta ilaçe.

Disa ekrane me mbushje të lëngut të kristal LCD nuk përputhen me frekuencën e kartës grafike të kompjuterit, kjo kërkon nga këta ekrane një regjistrim të fotografisë në përbërje të tyre.

Duket se beteja do të zhvillohet në mes River Plates dhe Barcelonës, pasi këta ekipe kanë oferta më të mira.

Po kështu ndodh dhe me përemrin dëftor *ata* kur përdoret në vend të trajtës *ato*:

Patëm diskutim publik pothuajse një muaj dhe të gjithë ata subjekte të cilët kishin mundësi i dorëzuan vërejtjet e tyre.

Më pak gabohet me përemrin dëftor *i tillë* duke pasur parasysh se vetë denduria e përdorimit të këtij përemri në fjali është e vogël:

Dihet që ka anëtarë të shumtë në forume të tillë.

Absurditete të tillë bëjnë njerëzit që nuk e njohin realitetin në të cilin jetojnë, që nuk i njohin kriteret elementare me të cilat sajohen veprat shkencore dhe historike.

Përdoruesit hasin mjaft vështirësi në përshtatjen e përemrit lidhur *i cili* me emrat ambigjenë:

Këtë vit pati shumë aplikime, prej të cilëve juria dalloi 18 që u përgjigjeshin kërkesave.

Megjithëse fare e re në moshë, këngëtarja ka realizuar disa albume të cilët janë nxjerrë në tregun muzikor.

Nga përemrat pyetës që kanë kategorinë gramatikore të gjinisë (*cili, i sati*), në shembujt e vjelë paraqet problem përshtatja e përemrit *cili* me emrat ambigjenë, ndërsa përemri pyetës *i sati* gabohet, por shembujt janë shumë të pakët, sepse vetë ky përemër përdoret shumë rrallë.

Cilët janë dy romanet më të rëndësishëm të jetës së tij?

Si do të jetë bota pas 25 vitesh, cilët aktorë të rinj do të kenë dalë në skenë dhe cilët konflikte do të kenë një ndikim mbi botën?

Cilët janë disa nga personazhet e pëlqyera nga ju dhe të tjerët?

Të satët u renditën gjimnazet e Tiranës?

Edhe më e ndërlikuar paraqitet përshtatja e numërorëve me kuptim përmbledhës me emrat ambigjenë.

Sipas gramatikës, në gjendjen e sotme kemi të bëjmë me një dysor normativ dhe si më i drejtë sugjerohet përdorimi pa tregues gjinie. Forma të dyja vajzat është shtrirje analogjike e përdorimit të emëruar (*Të dyja erdhën*).

Nga shembujt e vjelë, vihet re se përdoruesit janë të luhatur në përshtatjen e numërorit sipas gjinisë, por mbizotërojnë trajtat e numërorëve pa treguesin gramatikor të gjinisë:

Për veprën e këtij kleriku është shkruar në të dy botimet.

Probleme të përshtatjes së fjalëve përcaktuese me emrat ambigjenë

Nëse jeni në Gjermani dhe keni marrë nota shumë të mira në të dy vitet e parë, mund të aplikoni për një bursë nga një fondacion politik gjerman.

Po të ishte kështu, atëherë do të thonim që kam firmosur me të tre këta ekipe, - ka saktësuar numri 4 i kuqbluve.

Të tre këta mesazhe, me pohimet e tyre, më gëzuan jashtë mase duke marritur krenarinë kombëtare.

Shpesh emrat marrin më shumë se një fjalë përcaktuese. Kjo vihet re dhe në shembujt e marrë me emrat ambigjenë që mund të grupohen në:

raste ku të gjitha fjalët përcaktuese përshtaten si duhet:

Të gjendur përballë një situatë ku ata nuk kanë mundësinë e përfaqësimit, studentët duket se janë dorëzuar apo më saktë, alienuar për një moment nga të gjitha debatet e mundshme.

Këto personazhe publike kanë deklaruar se 150 paqeruajtës mund të kishin parandaluar pushtimin e saj.

Balerini i famshëm shqiptar, idhulli i mijëra e mijëra adoleshenteve italiane, do të shfaqet të premtën e ardhshme në të gjitha ekranet e mëdha të kinemave italiane.

raste ku ndonjë nga fjalët përcaktuese nuk përshtatet si duhet:

Kreu i shtetit i bëri thirrje parlamentit dhe institucioneve të tjera të përfshira në procesin zgjedhor që të respektojnë të gjithë afatet ligjore në përmbushjen e detyrave të tyre.

Ka një sipërfaqe prej 42 m² me të gjithë ambientet e përbashkëta dhe aktualisht është përfunduar për banim.

Flamurtarin e konsideroj si një kundërshtar si të gjithë ekipet e tjera, aq më tepër kur kujtoj se në ndeshjen e fazës së parë ka fituar me ne 3-2.

Midis të tjerash, të gjithë (ose pothuaj të gjithë) monumentet e krishtera të njohur për vlerat e tyre historike qëndrojnë më këmbë edhe sot e kësaj dite, sepse askush nuk i shkatërroi.

Ky është një problem për të gjithë vendet e rajonit dhe këta vende po bashkëpunojnë mirë me njëri-tjetrin për ta luftuar atë.

raste ku të gjitha fjalët përcaktuese nuk përshtaten si duhet:

Ky botim, pra, që ishte më i miri e më i ploti se të gjithë botimet e tjerë të mëparshëm, u mor si bazë për ribotim dhe janë bërë ndryshimet e nevojshme.

Sigurisht për të gjithë ata çifte që duan të provojnë këtë eksperiencë të re, u duhet të bëjnë një pagesë.

Të gjithë gabimet e mëtejshëm do të tregohen vetëm në terminal.

Po të shohësh të gjithë konfliktet e sotëm, shpejt e kupton që, ndonëse bipolariteti i Luftës së Ftohtë ka marrë fund tashmë prej 15 vitesh, bota vazhdon të kërkojë një rend të ri.

Gjatë procesit të kalimit të këtyre emrave në numrin shumë nga gjinia mashkullore në femërore, vëmendja e folësit përqendrohet më shumë në theksimin e sasisë, sesa në dallimin e gjinisë.

Shpesh përdoruesit u drejtohen fjalorëve për të gjetur zgjidhje, por jo rrallëherë mbeten pa përgjigje. Nga hulumtimi i bërë në fjalorë të ndryshëm shpjegues të shqipes (1980, 1984, 2006) për këtë grup emrash ambigjenë vihet re se:

Në të shumtën e rasteve në shpjegimin e fjalës përkatëse nuk jepet asnjë shembull i saj në numrin shumë, p.sh. *ekip, ekran, mesazh, roman* etj.

Në disa prej tyre jepet trajta e shumësit, por e pashoqëruar me fjalë përcaktuese mbiemra, përemra dhe numërorë për të parë përshtatjen e tyre në fjali, p.sh. *çift, dialekt, diamant, emision* etj.

Në pak raste trajta e shumësit jepet e shoqëruar me fjalë përcaktuese mbiemra, përemra dhe numërorë dhe përdoruesit e kanë të lehtë të bëjnë përshtatjen e duhur, p.sh. *kontakt, ligj, monument, tekst* etj.

Do të ishte e udhës që në këta fjalorë, në shpjegimet përkatëse të emrave të këtij grupi të jepen shembuj tipikë të emrave në numrin shumë të shoqëruar me fjalë përcaktuese.

Nga puna për vjeljen e shembujve për këtë dukuri u vu re se mbizotërojnë rastet kur respektohet ambigjenia, sidomos kur kemi të bëjmë me mbiemra që kanë trajta të dallueshme qartë në të dyja gjinitë. Megjithatë, siç shihet dhe nga shembujt ilustrues, nuk janë të pakta rastet kur përdoruesi has vështirësi në përshtatjen si duhet të fjalëve përcaktuese me emrat ambigjenë.

Probleme të përshtatjes së fjalëve përcaktuese me emrat ambigjenë

Literatura teorike

- Demiraj, Sh., *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972.
Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1973.
Fjalor i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006.
Gramatika e gjuhës shqipe I, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.
Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.
Matoshi, H., “Çështje të ambigjinitë në gjuhën shqipe”, *Gjuha shqipe*, nr. 1-2.
Topalli, K., “Rreth një paradigme të zhdukur të emrave të gjinisë femërore”, *Studime filologjike*, nr. 1-4, 1995, f. 15-24.

Faqe të ndryshme interneti

- <http://agideeba.blogstream.com/>
<http://albanian.cri.cn/1/2004/10/22/23@17932.htm>
<http://bakero207.wetpaint.com/page/MJEKESI?t=anon>
<http://hometown.aol.com/jehonaekrajes/page4.html>
<http://journals.aol.com/agideba/GjitheShkrimeteMija/>
<http://misioni.tripod.com/id5.html>
<http://muzika.albasoul.com/terejat.php?id=1429>
<http://shekulli.com.al/news/53/ARTICLE/7520/2007-03-30.html>
http://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuha_programuese_C
<http://www.albasoul.com/modules.php?op=modload&name=News&file=article&sid=678>
http://www.albic.net/Shqip/InfoBiznesi/Legjislacioni/ligje_tatime/18976.htm
<http://www.ballkan.com/index.php?page=shownews&newsID=43145>
<http://www.diskutime.com/disk/thread.php?id=2940>
<http://www.forumishqiptar.com/showthread.php?t=51455>
http://www.frosina.org/forum/forum_posts.asp?TID=5465
<http://www.gazetatema.net/?id=440>
<http://www.geocities.com/kaqaniku2001/html1.htm>
<http://www.gotquestions.org/Shqip/Rruga-shpetimit-Romaket.html>
http://www.ilo.org/public/english/region/eurpro/budapest/download/r_noad_albanian.pdf
<http://www.integrimi.com/print.php?page=shownews&newsID=29776>
<http://www.irr.org/mit/Is-Mormonism-Christian-Albanian.html>
<http://www.korrieri.com/index.php?k=1&i=39012>
<http://www.kosova.com/artikulli/36638>
<http://www.legislationline.org/upload/legislations/37/fa/fb13e5a6fc4969388c3f94a169b4.htm>
<http://www.lpk-kosova.com/>

<http://www.lsi-al.org/index.php?page=news&news=923>
[http://www.magjistratura.edu.al/skedaret/1129642591-UN Rules for Protection of Juveniles deprived of liberty Alb.doc](http://www.magjistratura.edu.al/skedaret/1129642591-UN%20Rules%20for%20Protection%20of%20Juveniles%20deprived%20of%20liberty%20Alb.doc)
<http://www.medialb.com/lajmet/rubrika.asp?lajmeid=15271>
<http://www.metamorphosis.org.mk/ICT/doracak.pdf>
<http://www.nyc.gov/html/hhc/downloads/pdf/open-letter-albanian.pdf>
<http://www.president.al/shqip/info.asp?id=217>
http://www.pr-tech.net/per_shtypes.php?lajmi_id=1086
<http://www.ps.al/meshume.aspx?id=403>
<http://www.radiokosovaelire.com/komentet.php?id=52>
<http://www.revistakuvendi.com/index.htm>
http://www.shqiperia.com/faqjapare/erwin_hatibi.php
<http://www.shqiperia-etnike.com/she31/she31shqip.htm>
<http://www.sitecenter.dk/syla/poezi1/>
http://www.spekter.com.al/165/femra_karrieri.htm
<http://www.studentet.info/modules/ipboard/index.php?showtopic=908>
<http://www.tatime.gov.al/?fq=info&metod=shfaqart&artID=317>
<http://www.tepelena.com/revista/opinion/esh.kosova.htm>
<http://www.tirana.gov.al/?cid=1.93.1004>
<http://www.unesco.org/most/Fashikulli-1B.pdf>
<http://www.uni-pr.edu/dokument/Rregulloreperprocedurendisiplinore.pdf>
<http://www.voanews.com/albanian/archive/2003-04/a-2003-04-15-8-1.cfm?renderforprint=1&textonly=1&&TEXTMODE=1&CFID=97693592&CFTOKEN=27622498>
http://www.worldlearning.org/wlid/star/albanian/about_star.html
http://www.worldslastchance.com/wlcarticle_albanian.php